MESAZH ME RASTIN E HYRJES SË HËNËS SË RE TË MUAJIT SHABAN 14442/2021

SHENJAT E KIAMETIT

NË TETOVË... MBRESA

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 3 (217), Mars, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

MYFTIU: “XHAMIA E PLUMBIT, GJURMË E TRASHËGIMISË ARNAUTE TË ARKITEKTURËS...”

Myftiu e falënderoi kryeministrin Rama për vizitën dhe përpjekjen për restaurimin e shumëpritur të xhamisë së Plumbit, sikurse shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për presidentin e Turqisë, ShTZ. Rexhep Taip Erdogan për përkushtimin e shfaqur ndaj kësaj xhamie dhe qëllimit fisnik të bashkëpunimit me qeverinë shqiptare për zbatimin e projektit, që pritet të jetë zgjidhje për problemin e përmbytjes së paevitueshme prej shumë dekadash të kësaj xhamie historike.

Myftiu theksoi se xhamia e Plumbit ka një veçori... *(f.16)*

PËRKUJTOHET NATA E MADHE E ISRASË DHE MIRAXHIT

Mbarë bota islame kremtoi të mërkurën, më 10 mars 2021, Natën e Madhe të Israsë dhe të Miraxhit.

Edhe në Shqipëri u përkujtua Nata e Mirë, ku në xhamitë e ndryshme, edhe pse në kushte të vështira pandemie u bënë dua-lutje, programe fetare, këndime ilahi dhe salavate.

Ndërsa, në metropolin verior, në Shkodër, Myftinia e kësaj zone zhvilloi në xhaminë e Parrucës, pas iqindisë aktivitetin me temë:”Në përkujtim të mrekullisë së Israsë dhe Miraxhit”.... *(f.16)*

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

MESAZH ME RASTIN E HYRJES SË HËNËS SË RE TË MUAJIT SHABAN 14442/2021

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër dhe motra besimtarë, muslimanë!

Më lejoni që në prag të ezanit të akshamit të kësaj Nate të Madhe t'ju uroj me zemër me rastin e fillimit të muajit të begatë të Shabanit, i cili i paraprin muajit të madhëreshëm të Ramazanit.

Me fillimin e Hënës së këtij muaji të begatë të gjithë ne jemi të ftuar nga Zoti i Gjithësisë që të përfitojmë maksimalisht nga koha për të hyrë në një marrëdhënie të re me Krijuesin tonë në prag të muajit të madhëreshëm të Ramazanit.

A e keni vënë re se sa herë ne bëhemi gati për një udhëtim të largët, për të realizuar një dëshirë apo një qëllim fisnik, nuk e lemë përgatitjen për ditën e fundit, por bëhemi gati me mendimet tona, me përfytyrimet tona si dhe me shënimet tona për këtë udhëtim.

Na pyesin se kur do të shkojmë, kur do të jetë udhëtimi? Dikush na kërkon që t'i sjellim diçka, dikush diçka tjetër. Ata që kanë udhëtuar drejt Qabes së madhëreshme ose Medines së Pejgamberit (a.s), apo kanë vizituar Kajron, Damaskun, Stambollin, etj dhe është përhapur fjala se do ta bëjnë këtë udhëtim; e keni parasysh se si njerëzit vijnë për t'i uruar; dikush i kërkon një dhuratë, dikush i kërkon një kujtim e kështu me radhë.

Edhe njeriu vetë, kur bëhet gati për një udhëtim të veçantë në jetën e tij apo bëhet gati për të pritur një mik të veçantë në jetën e tij, fillon e përgatitet, rregullon shtëpinë, rregullon makinën, pajisjet e ndryshme me të cilat do t'i shërbejë mikut të tij. Në këtë mënyrë ai bëhet gati që kur të vijë miku ta gjejë gjithçka sipas dëshirës së tij dhe ta presë me zemër të madhe. Ashtu edhe muaji i Ramazanit, kërkon nga gjithsecili prej nesh që të përgatitet dhe mos ta lërë angazhimin për pritjen e tij në natën e fundit të muajit Shaban.

Tashmë ky muaj që po vjen sjell me vete një porosi të madhe nga Pejgamberi (a.s). E pyeti një ditë Hz. Usame ibn Zejd (r.a) dhe i tha: "Ja Resulallah, nuk të kam parë të agjërosh një muaj tjetër, përveç Ramazanit, si muajin Shaban". Pejgamberi (a.s) i tha: "Ky është një muaj në të cilin shumë njerëz janë neglizhentë dhe janë të hutuar, ndërmjet Rexhebit dhe Ramazanit. Në këtë muaj lartësohen veprat tona tek Allahu (xh.sh) dhe unë dua që kur të shkojë vepra ime te Zoti i Gjithësisë të jem agjërueshëm!" Subhanallah!

Është një nxitje shumë e madhe, të dashurit e mi, që të përgatitemi me agjërim, të përgatitemi me istigfar, të përgatitemi me sadaka, me kontrollimin e fjalëve, me kontrollimin e mendimeve, me kontrollimin e sjelljeve, të bëhemi gati për pritjen e Ramazanit në mënyrë që atmosfera e begatë e këtij muaji mubarek që po vjen të na përfshijë kohë më përpara.

A nuk i keni dëgjuar sahabët e Pejgamberit (a.s), sikurse na thonë librat e hadithit, se përgatiteshin për Ramazan 6 muaj përpara se të vinte!? A nuk e keni besuar se Pejgamberi (a.s), e ka pritur Ramazanin me agjërim, e ka pritur Ramazanin me vepra të mira, me sjellje të mira, me shtimin e adhurimeve, me përsosmërinë e adhurimeve? A nuk kuptojmë prej kësaj fjale të madhe të Pejgamberit (a.s) se është momenti që gjithsecili prej nesh të bëhet gati, sepse një mik i madh po vjen dhe një mundësi e madhe po vjen dhe, nuk e dimë a do t'ia mbërrijmë apo jo asaj dite të begatë!?

Tashmë që muaji Shaban po afrohet, edhe pak po shfaqet Hëna e re e këtij muajit të begatë, ta bëjmë nijetin që nga ky moment për të pritur muajin e madhëreshëm të Ramazanit me përsosmërinë dhe kontrollimin e

Vëllezër e motra! Zgjohuni nga gafleti, siç thotë Pejgamberi (a.s), një muaj ndaj të cilit njerëzit janë në gaflet, pra që nuk ia dinë fort vlerën e tij. Zgjohuni nga gafleti dhe përgjigjuni thirrjes së Pejgamberit (a.s), përgjigjuni thirrjes së Allahut (xh.sh), sepse po na vjen Ramazani!

adhurimit dhe sjelljeve tona duke filluar nga ky muaj i madhëreshëm i Shabanit. Të lëmë pas krahëve fjalët, thashethemet, angazhimet e panevojshme dhe të pakuptimta që na bëjnë të largohemi nga thelbi i besimit dhe thelbi i adhurimit, sidomos në këtë periudhë të begatë.

Muaji Rexheb, një muaji i madhëruar në Kuranin Famëlartë, një muaj i begatë për të cilin ka sinjalizuar vetë Zoti i Gjithësisë, përfundoi e shkoi. Lum ata që përfituan dhe u angazhuan më shumë sesa muajt e tjerë në këtë muaj të madhëreshëm dhe mjerë për ata, të cilët gabimisht i morën për dore njerëzit në thashetheme dhe drejt neglizhencës ndaj hakut të këtij muaji të begatë dhe madhnueshëm!

Prandaj, tani që po vjen Shabani mos të bëhemi prej atyre që neglizhojnë, siç thoshte Pejgamberi (a.s)!

Pra, njerëzit hutohen e neglizhojnë, nuk e dinë vlerën e këtij muaji të madhnueshëm në të cilin lartësohen veprat tona, i paraqiten Zotit të gjithësisë. Ndërkohë Pejgamberi thotë: "...Unë dua që vepra ime, kur të lartësohet, të shoqërohet me agjërimin..."! Pse me agjërimin? Pse jo me namazin, pse jo me sadakanë, pse jo me një vepër tjetër? Sepse agjërimi ka një sekret, i cili dominon mbi sekretet e krejt adhurimeve të tjera: "Agjërimi është i Imi", - thotë Allahu (xh.sh) dhe vetëm Ai e jep shpërblimin për të!

Imagjinoni kur vepra e gjithsecilit të lartësohet dhe bashkë me të të jetë edhe agjërimi si ndërmjetës tek Zoti i gjithësisë për t'u pranuar vepra!

Nëse nuk e ke bërë nijet deri në këto momente, bëje nijet nga sot, nga ky çast që të nisësh një hatme të Kuranit dhe ta përfundosh pa arritur muaji i Madhërueshëm i Ramazanit.

Nëse netët e tjera i ke neglizhuar dhe ke fjetur, ndoshta pa falë edhe jacinë, ndoshta pa falë edhe vitrin, ndoshta pa falë e pa falë, bëje nijet nga ky moment që sonte me përfundimin e jacisë të falesh edhe 2 rekate, qoftë edhe 2 rekate të vogla si namaz kijamul-lejl, si namaz nate dhe t'i lutesh Allahut të Madhëruar, në sexhden e këtij namazi, sado i shkurtër të jetë, për mbarësinë tënde, për faljen tënde, për mëshirimin tënd, për begatinë tënde, për rizkun tënd, për familjen tënde, për vëllezërit e tu, për motrat tuaja, për studimet tuaja, për shkollën tënde, për punën tënde, për mbarësinë, të të japë Allahu i Madhëruar, për shëndetin, të të japë Allahu (xh.sh), pra të të begatojë në prag të këtij muaji të madhëreshëm që po vjen; që është Ramazani mubarek!

Vëllezër e motra! Zgjohuni nga gafleti, siç thotë Pejgamberi (a.s), një muaj ndaj të cilit njerëzit janë në gaflet, pra që nuk ia dinë fort vlerën e tij. Zgjohuni nga gafleti dhe përgjigjuni thirrjes së Pejgamberit (a.s), përgjigjuni thirrjes së Allahut (xh.sh), sepse po na vjen Ramazani!

Ramazanin duhet ta presim në mënyrën më të mirë të mundshme, duke i dëshmuar Allahut përkushtimin e zemrës, angazhimin për t'u paqtuar me njëri-tjetrin, për të falur ata që na kanë hyrë në hak, për t'u toleruar brenda mundësive, për të bërë mirë sa kemi mundësi, për të shikuar tek të afërmit tanë, tek komshinjtë a kanë diçka nevojë për t'i ndihmuar?

Nëse kemi mundësi të ndihmojmë dikë, nëse kemi mundësi për të zgjidhur problemin a hallin e dikujt, mos të ngurrojmë e me e ba, të dashurit e mi, sepse nuk e dimë, se cila vepër pranohet, me cilën vepër zbardhen fytyrat tona përpara duarve të Allahut, e përpara gjithësisë në ditën e madhe të mahsherit!

I lutemi Allahut (xh.sh) për hatrin e emrave Tij të madhnueshëm, për hatrin e Esmaul-Husna, për hatrin e Pejgamberit (a.s), për hatrin e Kuranit Famëlartë, që këto momente që po na afrohen dhe ky muaj i madhëreshëm që po vjen dhe që i paraprin Mubarekut Ramazan, të jetë një mundësi e madhe nga Zoti i Gjithësisë për gjithsecilin prej nesh për t'u afruar e për t'u lartësuar, për t'u ndryshuar në jetë dhe për të rilidhur një besë të madhe me Zotin e Gjithësisë, si për t'i thënë: *Lebejkallahume lebejk*: – Unë të përgjigjem ty o Zoti im, në këtë muaj të begatë që po vjen, në këtë Shaban Mubarek dhe në këtë Ramazan Mubarek dhe në çdo ditë, në çdo muaj e në çdo vit të jetës sime, të përgjigjem për të ardhur pas thirrjes Tënde, për të jetuar me dritën Tënde e për të përhapur me sa të kem mundësi dashninë Tënde.

Allahu ju dashtë e ju begatoftë! Me zemër të mirë Shabanin Mubarek, e me zemër të mirë çdo moment në të cilin ne afrohemi me Allahun (xh.sh).

Allahu e pranoftë adhurimin tuaj, lutjet tuaja, istigfarin tuaj, agjërimin tuaj, sadakanë tuaj, përpjekjen për të ndërtuar ura dhe për të përhapur të mirën gjithandej sa të jemi në këtë botë.

Dr. Muhamed S. R. El-Buti
(1929 - 2013)

"Sado që njeriu të arrijë prej adhurimit në kohë të ndryshme adhurimesh, si p.sh, Nata e Gjysmës së Shabanit, por zemrën e tij e ka të mbushur me urrejtje dhe smirë, e ka të mbushur me egoizëm dhe mashtrime ndaj robërve të Allahut të Madhëruar, Allahu nuk ia pranon agjërimin e tij, as zekatin, as nuk e shikon atë njeri dhe as nuk ia pranon lutjen e tij; por ia ngrinë lutjet, derisa të rregullojë gjendjen e tij!



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

SHENJAT E KIAMETIT

Dikush më pyeti: Na fol për shenjat e kiametit apo për ndonjë shenjë të ditës së kiametit.

Me ngadalë iu përgjigja dhe i thashë: Nuk i kushtoj shumë rëndësi kësaj teme tani!

Tha: E, përse?!

I thashë: Njerëzit i shtynë ta bëjnë këtë pyetje, kërshëria për kureshtjen apo të folurit rreth gjërave të fshehta. Kjo bisedë, nganjëherë mund të jetë si një lloj çlodhjeje nga mërzitja e qenies njerëzore në kryerjen e asaj që kanë detyrë për të kryer.

I thashë: Dikush nga njerëzit e asaj kohe, shkoi te Pejgamberi (a.s) për ta pyetur rreth kiametit; sikur Pejgamberi (a.s) e ndjeu se këtë njeri e ka nxitur ta bëjë këtë pyetje dëshira e shuarjes së diçkaje që ka në veten e tij, veçanërisht për të, dhe i thotë: "E, çfarë ke përgatitur për të?"

Ky njeri ishte tepër orator, dhe i thotë: Kam përgatitur për të, dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij!

Pejgamberi (a.s) i tha: "Njeriu është me atë që ka dashur!"

Pyetësi më tha: Megjithatë, ne po të kërkojmë të na flasësh për shenjat e kiametit.

I thashë: Me thënë të drejtën, jam i zënë me të afërmen ndaj më të largëtës!

Tha: Cila është e afërm për ty dhe cila është e largët nga ty?

I thashë: Unë mendoj se kiameti është larg nga unë, ndërsa afër meje është vdekja, që është varri! Kështu që unë po përgatitem për varrin, më shumë se sa përgatitja ime për ditën e kiametit!

Nuk mendoj, se dita e kiametit do të vijë dhe unë të jem gjallë, sepse mes jetës sonë tani dhe mes ardhjes së kiametit ka shenja të mëdha... Vërtetë, se shenjat e vogla janë të shumta, ku anarshia do të përhapet në tokë dhe do të shtohet ateizmi, por shenjat e mëdha të kiametit, siç e përmend Kur'ani Famëlartë, dalja e një shtaze (krijese), e ku ta dimë se çfarë shtaze është: "E, kur të bëhet realitet fjala ndaj tyre, atëherë do t'u nxjerrim një shtazë (krijesë) prej toke, që do t'u flasë, se njerëzit, ndaj argumenteve tona, kanë qenë jo të bindur!" - (Kur'ani, En-Neml: 82)

Rreth kësaj shtaze (krijese) nuk ka ndonjë gjë që meriton të thuhet për përshkrimin e saj. Unë, personalisht, jam i mendimit, se shtaza (krijesa) vjen për njerëzit, të cilëve Allahu u ka dhënë mendje të zgjuar dhe meditim të thellë, e megjithatë nuk e kanë njohur Zotin e tyre, për t'u thënë atyre, se shtazët flasin tani për t'ju bërë të ditur gabimin tuaj, o njerëz! Ju është dhënë mendja dhe me të nuk e keni besuar Allahun, dhe e keni mohuar!

Nëse një shtazë flet për të sulmuar racën njerëzore ndaj mosbesimit (mohimit) të tyre, kjo mund të jetë prej shenjave të kiametit, siç ka ardhur në ajet. Ndoshta mund të ndodhin edhe gjëra të tjera, por unë mendoj, se tani kiameti nuk është afër meje.

Unë mendoj për kiametin tim... unë pas disa ditësh, nuk e di, ndoshta pas disa muajsh... nuk e di, ndoshta pas disa vitesh, patjetër do të largohem nga kjo dynja, nuk kam për të qenë i përjetshëm në të, toka do të rrijë rehat nga unë, siç ka qenë rehat më parë.

Dielli do të lind dhe rrezet e tij nuk do të bien mbi trupin tim, sepse trupin tim, tashmë e ka mbuluar dheu. Unë jam duke u përgatitu për këtë, që kur të vijë dita e kiametit, e të dal prej berzahut, siç dalin edhe të vdekurit e tjerë, e sa të shumtë janë të vdekurit, të cilët janë palosur nga brezat e kaluar!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

KURANI ËSHTË BURIMI I LAJMEVE TË MIRA

Shumë herë njeriu gjatë jetës së tij gjendet në situate të vështira ku e humb shpresën për të vazhduar më tutje. Faktorët e kësaj gjendjeje janë të ndryshëm ku një ndër këto faktorë është informimi pesimist apo keq-informimi. Edhe neve shumë herë na ndodhë që nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të bombardohemi me lajme nga më të ndryshmet që japin pak shpresë për të vazhduar më tutje.

Humbja e shpresës ia shkatërron njeriut vullnetin dhe vendosmërinë për të ecur para. Ajo bën që njeriu të harrojë parimet dhe vlerat për të cilat përpiqej më parë.

A duhet të ndikohemi nga informacionet të cilat nuk japin fare shpresë, apo kemi ndonjë kanal televiziv të caktuar që informon mirë, saktë, dhe jep shpresë? Padyshim që po.

Gjithmonë rrugëdalja, burimi i shpresës dhe informimi i duhur është të fjalët e Allahut të Madhëruar. Prandaj ne si besimtarë e kemi obligim që gjithmonë dhe në çfarëdo situate që ndodhemi të kapemi për fjalët e Allahut (xh.sh).

Kurani është shpëtimtari, rrugëdalja prej trazirave dhe problemeve, sipas deklaratës së Profetit (a.s) i cili një ditë i tha Aliut (r.a): "Pas meje do të ketë shumë probleme dhe trazira". Aliu (r.a) e pyeti: "O Profet i Zotit, cila është rrugëdalja prej trazirave?" Profeti (a.s) u përgjigj: "Libri i Zotit është rrugëdalja prej trazirave...".[1]

Kurani është i domosdoshëm për zemrën dhe shpirtin, ashtu siç ka nevojë edhe toka për shiun. Këtë nevojë që ka zemra për Kuranin, e shpreh hadithi dhe duaja e Profetit Muhamed (a.s): "Nuk ka njeri që e kaplon mërzia e pikëllimi, dhe duke u lutur me këto fjalë: "O Zoti im, unë jam robi Yt,...bëje Kuranin pranverë të zemrës sime, dritë të gjoksit tim, heqje të pikëllimit dhe largim për dëshpërimin" dhe Allahu të mos t'ia largojë hallin dhe mërzinë, duke ia zëvendësuar me rrugëzgjidhje".[2]

A jemi mirënjohës ndaj Allahut të Madhëruar për këtë libër madhështor të cilin kushdo që e ka lexuar i është referuar apo ka punuar me te ka dalë triumfues.

Kurani Famëlartë ka shumë emra dhe cilësi. Ata janë aq shumë sa që dijetarët muslimanë kanë shkruar libra të posaçëm në lidhje me këtë temë. Një nga emrat dhe cilësitë kryesorë që ka ky libër është që Allahu (xh.sh) e ka quajtur lajm i mirë.

Allahu (xh.sh) thotë: "Kurani është udhërrëfyes dhe lajm i mirë për besimtarët".[3] Nga kjo kuptojmë që sa herë që besimtari i qaset këtij libri duke e lexuar, studiuar, komentuar... etj, gjithmonë do të hasë në karakterin përgëzues që freskon zemrën ngjall shpirtin dhe të jep forcë dhe vullnet për të vazhduar më tutje.

Allahu (xh.sh) në shumë vende në Kuran përgëzon...

"Jepu lajme të mira atyre që janë të përulur (ndaj Zotit)".[4]

"Jepu lajme të mirë besimtarëve (se do fitojnë xhenetin)".[5]

"Përgëzoji durimtarët".[6]

"Jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve".[7]

Kush po jep myzhde? Zoti i gjithësisë i cili për vetën e Tij në Kuran thotë:

"Nuk ka dyshim se Allahu e kryen premtimin e Tij".[8]

Lajmet e Kuranit i eliminojnë të gjitha lajmet e tjera. Allahu (xh.sh) në Kuran thotë: "Pa dyshim, bashkë me vështirësinë vjen lehtësimi".[9] Këtë Allahu (xh.sh) e ka përmendur dy herë në të njëjtën sure në suren El-Inshirah (Hapja e kraharorit). Ibn Abasi (r.a) thotë: "Një vështirësi nuk i mund dot dy lehtësime".[10] Ky është një lajm i mirë për Pejgamberin (a.s) dhe mbarë ymetin. I Dërguari u ndodh në situata të vështira sa ishte në Meke, në Taif, madje edhe në Medinë për shkak të hipokritëve.

Kur të ngushtohet gjoksi nga telashet, problemet nga lajmet e këqija e tjerë lexoje këtë sure e cila të zgjeron gjoksin dhe mendjen tënde.

Ashtu siç gjejmë kohë për të ndjekur lajmet dhe programet e ndryshme të ndajmë kohë edhe për këtë edicion lajmesh që janë lajmet e Kuranit. Ashtu siç gjejmë kohë për shfletimin e portaleve të ndryshme të gjejmë kohë edhe për shfletimin e Kuranit.

E lusim Zotin e gjithësisë t'i falë gabimet dhe mangësitë tona ndaj librit të Tij.

O Zot bëjë Kuranin pranverë të zemrave tona, largim të streseve dhe halleve tona.

O Allah mbushi zemrat tona me dashurinë për Ty, për fenë Tënde, për librin Tënd, për Profetin Tënd dhe për të gjithë muslimanët.

1. Tirmidhiu, 2906.
2. Ahmedi.
3. En-Neml, 2.
4. Kurani, El-Haxh: 34.
5. Kurani, El-Bekare: 223.
6. Kurani, El-Bekare: 155.
7. Kurani, El-Haxh: 37.
8. Kurani, Err-Rrad, 31.
9. Kurani, El-Inshirah: 5.
10. El-Muvetta, 2/446; Ibn Ebi Shjejbe, 5/335; Bejhekiu në veprën Shuab el-Iman, 7/205.

NË TETOVË PROMOVOHET LIBRI "VE ALEJKES-SELAM"

Pasditen e së enjtes, më 25 mars 2021, Shtëpia botuese ASR, nën ombrellën e Fondacionit ASR mbajti promovimin e botimit të dytë të librit: "Ve alejkes-Selam…", të myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari

Ky aktivitet i begatë u zhvillua në qytetit të Tetovës dhe në të morën pjesë intelektualë, miq dhe studiues, kjo duke respektuar dhe ndjekur masat mbrojtëse të situatës pandemike. Mysafir nderi ishte edhe koordinatori i Medresesë së Luginës së Preshevës, prof. Ismail ef. Halimi së bashku me prof. Lulzim ef. Hasanin.

Hapja e programit u bë me lexim të një pjese kuranore nga hoxha dhe muhafizi i Shkupit, Miftar ef. Islami. Pastaj fjalën e mori udhëheqësi i programit z. Imran Mehmedali, i cili me prezantoi biografinë e begatë të myftiut të Shkodrës, imam Muhamed B. Sytari.

Fjalën vijuesi e mori drejtori gjeneral i Fondacionit ASR, hoxha dhe muhafizi i Tetovës, Abdurrahman ef. Asllani, i cili në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi lartë figurën dhe kontributin e myftiut Sytari.

Më tej aktiviteti vijoi me vlerësimin kritik të librit nga këndvështrimi i prof. dr. Jeton Shasivarit, ligjërues në Universitetin e Evropës Juglindore, pastaj mori fjalën prof. dr. Xhahid Bushati, kritiku letrar, shkrimtar dhe poeti i njohur shkodran.

Në fund fjalën e mori myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili me fjalët dhe këshillat e tija të arta la mbresa të thella tek të pranishmit. Pas fjalimit të tij dhe në fund të programit, Myftiu bëri edhe nënshkrimin e librit për dashamirët e tij.

Pas promovimit të librit, myftiu i Shkodrës së bashku me bashkëpunëtorët dhe miqtë e tij vizituan objektin e Fondacionit ASR. Vizitën e tyre të trojeve të këtejme e përmbyllën me zijaretin e muhafizit më të madh të shqiptarisë, mulla Mahmud ef. Asllanit.

Shtëpia botuese ASR për këtë emnesë të madhe përjetësisht i është falënderuese myftiut Sytari për bashkëpunimin e tij vëllazëror dhe respektin e tij të madh. Gjithashtu falënderojmë edhe gjithë të pranishmit si dhe kontribuuesit për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti!

(Me përshtatje nga faqja zyrtare e "Mexhlisi Asr" në fb)

NË TETOVË... - MBRESA -



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Sot është ditë e enjte dhe data shënon 25.03.2021. Pranë kësaj date, ditë më parë, kam vënë dhe një shënim… Nga ato shënime që brenda atyre fjalëve fshehin emocion, kanë të jashtëzakonshmen e tyre. Është ditë kujtese dhe ditë libri. Vetë libri është univers diturie dhe, për rrjedhojë edhe kjo ditë ka universin e saj, me fytyrë prej libri.

Sikur numëroja ditët… Ajo ditë erdhi.

Është mëngjes, herët. Një mëngjes i manushaqtë, ku drita i ka çelur sytë e saj të bukur. Nuk vonojmë dhe nisim rrugëtimin tonë drejt Tetovës. Jemi të ftuar nga Sh. B. "ASR", në promovimin e librit "VE ALEJKES–SELAM" të autorit Muhamed B. Sytari. Si bashkudhëtarë të autorit jemi edhe një grup shoqërues: Xhahidi, Lavdrimi dhe Iliri.

Në Shkodër, na ndjek një erë e ftohtë marsi. Në "Rrugën e Kombit" na ndjek era e ftohtë me ca rreze dielli, si për të na thënë: "Pranvera po vjen…". Na shoqëron edhe bora maleve si një bardhësi e çmueshme që fsheh magjinë e përrallave. Një borë e qetë, paqësore dhe e ëmbël.

Ndalojmë për të pirë kafe te lokali me emrin "Lugina e Drinit". Përballë nesh janë malet, të mbuluara nga bardhësia e borës. Disa prej tyre, vende-vende ruajnë kaltërsinë e tyre si autencitet. Nuk më ka qëlluar të jesh përballë borës, të ngrohesh nga rrezet dhe të mos ndiesh të ftohtë. Siç duket bora e ka ruajtur një mirësi të tillë për ne.

Edhe gjatë rrugës së Kosovës, edhe gjatë rrugës së Shkupit: era e ftohtë, rrezet e diellit që të ngrohin më shumë e bora që "strehohet" në male mbeten bashkudhëtarët tanë: miqësorë, poetikë dhe dashamirës. Gjatë rrugëtimit tonë pamë se disa male dhe vargmale bardhësinë e borës dhe kaltërsinë që mbizotëronte e ruanin si pasuri të çmueshme. Ishte një pasuri që të ka ënda ta shikosh. Mos kjo ndodhi magjike e shfaq marrëdhënien e saj vetëm në përralla?, - por jo vetëm. Siç duket bardhësia e borës zbut,shpesh, edhe epizmin e maleve.

Në Tetovë, mbërrijmë, diku, aty afër mesditës. Edhe në këtë qytet të heshtur, të ditur, të mençur, na pret një diell i ngrohtë që me buzagazin e tij sikur sfidon erën e ftohtë, së cilës, përmes rrezeve ia zbut zemërimin.

Në një nga lokalet fillon promovimi i librit "VE ALEJKES–SELAM" të autorit Muhamed B. Sytari. Promovimin e rrethon një dritë mikëpritëse, e cila ka si vatër shikimin, fjalët, buzëqeshjen dhe kulturën e Drejtorit gjeneral të Fondacionit ASR, hoxhës dhe muhafizit të Tetovës, Abdurrahman ef. Asllani. Fjala e tij e dalë prej shpirti ka ngjyra dashamirësie, vëllazërimi, buzëqeshjeje dhe ëndërrimi të bukur. Në mes të diskutantëve, tërheq vëmendja e fjalëve dhe argumenteve të prof. Jeton Shasivarit. Me fraza të zgjedhura prej një shqipeje të artikuluar bukur, me një kadencë të ëmbël e të qartë, por me kompetencë juridike ndalet në disa aspekte të librit, që diskutantit i kanë bërë përshtypje. Këto përshtypje, që prof. Jetoni i vlerëson si cilësi të vyera, i evidenton duke i zbërthyer në këto rrafshe shikimi, siç janë: haku në të drejtën, djersa e ballit, ndershmëria… etj. Profesor Jetoni, në fjalën e tij, i sjellë te të pranishmit, si për t'u thënë: "… ato janë copëza pasurie amaneti dhe dinjiteti të njeriut".

Më pas, edhe autori i këtyre radhëve, në fjalën e tij, foli për tipologjinë e librit, përmbajtjen e tij, vlerat që sjell dhe përse duhet lexuar ky libër i vlefshëm.

Në fund e mori fjalën autori i librit, Muhamed B. Sytari. E folura e tij e dritshme dhe plot rrjedhshmëri, ishte një rrëfim dobiprurës, veçanërisht me të rinjtë, për të sotmen dhe të ardhmen e tyre, dhe njëherazi për universin e fesë islame, për shpërndarjen e urtësisë, diturisë, virtytit dhe vizioneve të saj.

Autori, Muhamed B. Sytari, përmes këshillave, mesazheve që shfaqen dhe përfaqësohen në kufijtë e shkrimeve që përmban libri a përtej tij, rrezatojnë dimensione teologjike, edukuese e kulturore… etj. Këto vlera të arritura që shpërfaqen në këtë libër vijnë si rrjedhojë e një pune këmbëngulëse. Një punë që në rrugën e tij të Thirrjes Islame gjen dhe dritare të reja diturie, dritare që pasurojnë bibliotekat.

Nuk është hera e parë që autorin e këtij libri e dëgjoj në rrëfimet e tij, në bisedat e vlefshme të tij, në komunikimet e tij. Nuk është sekret po të them se vjen nga një rrugë kërkimesh e studimesh në fushën e teologjisë e përtej. Edhe sot është i njëjti ritual për të. Ai punon pa rreshtur, shënon, nënvizon, krijon, argumenton… Biblioteka është jeta e tij. Me të u rrit, me të komunikon, dëgjon urtësinë e të diturëve…, përsëri komunikon… Ky rrugëtim është i pandalshëm. Dhe nuk mund ta kuptosh jetën e tij prej misionari pa këtë burim dijesh. Dhe këtë model nuk e gjen shpesh. Ai, në rrugëtimin e tij jeton përmes gjurmëve të traditës dhe të sotmes, duke i hedhur sytë drejt së ardhmes. Kuvendimet e tij me librat, me të urtit, me ata që botës i kanë dhënë e i japin fet-va vazhdimisht… është i pandalshëm dhe i çdoditëshëm. Ndaj e bëjnë autorin Muhamed B. Sytari të hyjë dinjitetshëm në rrugën e radhët e Dijetarëve me opusin e tij vetjak dhe kulturologjik.

Në Tetovë, mbërrijmë, diku, aty afër mesditës. Edhe në këtë qytet të heshtur, të ditur, të mençur, na pret një diell i ngrohtë që me buzagazin e tij sikur sfidon erën e ftohtë, së cilës, përmes rrezeve ia zbut zemërimin.

Dhe dijetari Muhamed B. Sytari nuk u largua nga Tetova, pa e takuar Mulla Mahmud ef. Asllanin. Vetë Mullai i nderuar e fisnik është bibliotekë, është urtësi… E autori shkon drejt kësaj biblioteke si një nxënës që kërkon dije… Mullai, edhe pse mosha e tij po kapte shekullin, teksa komunikonte zëëmbël me autorin Sytari, mua më dukej sikur nëpër kohëra flisnin dijet dhe bibliotekat.

Vetë Mullai i ngjante një libri që ende duhej shfletuar… Ndaj studiuesi Sytari shkoi jo vetëm për ta takuar, por për të lexuar dhe ca faqe më shumë. Pse donte të lexonte këto faqe të ndritura, Dijetarit Sytari nuk i ikej nga Tetova, pa e takuar Mullain e nderuar fjalëurtë. Ai po vinte drejt Shkodrës së dashur me një bibliotekë të re…

Shkodër, 28.03.2021

KUJTIMET E HAXHIT, DRITË MALLI, QË ZEMRËS I JEP JETË!

Libri “Kujtime nga Haxhi - (rrugëtimi i vitit 2018)”, i të nderuarit Haxhi Qemal Rushiti, është pa dyshim një kontribut i vyer në dëshmimin e emocioneve të një udhëtimi të papërshkrueshëm, kujtimeve të së cilit, sa herë i qasemi na mbushin me dritë malli dhe mirësi bekimesh të pashembullta!

Duhet falënderuar autori për këtë kontribut të vyer, që zë një vend të veçantë në literaturën islame në gjuhën shqipe, për shkak të gjurmëve që lë në memorien njerëzore udhëtimi i mrekullueshëm i Haxhit!

Autori ka përzgjedhur një stil të veçantë në regjistrimin e kujtimeve të tij, duke ndërthurrur shënimet personale me fotografitë e shoqëruara me diçiturat e natyrshme dhe të ndjera...

Libri është i mbushur me stacione kujtimesh, emra të shumtë personazhesh të nderuar, që e zbukurojnë atë me praninë e tyre të natyrshme, si dhe fotografitë e bukura e krejt spontane, që veç se e pasurojnë këtë shprehje të mrekullueshme të ndjesive të Haxhit dhe vizitës së Pejgamberit (a.s).

Janë stacione malli e besimi, që jemi të ftuar t’i lexojmë, për të ndjerë sinqeritetin e autorit, që i thotë gjërat ashtu siç i ndjen, ashtu siç i dëshmon, ashtu siç i prek, në një çaat mrekullie në jetën e tij!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari

(Nga fjala e mbajtur në promovimin e librit: “Kujtime nga Haxhi - (rrugëtimi i vitit 2018)”, i të nderuarit Haxhi Qemal Rushiti, ditën e xhuma, më 12 mars 2021, në xhaminë e Orashës, Maqedonia e Veriut)

LËNIA E LEXIMIT PAS IMAMIT, QOFTË NAMAZ ME ZË APO PA ZË

Argumentet e hanefijve nga hadithi.

1.1. Transmetohet prej Imran ibn Husajnit r.a. se “duke e falur Pejgamberi a.s. drekën, një njeri nga pas filloi të lexojë “Sebbihisme rabbike’l e’ala”. Kur e përfundoi namazin Pejgamberi a.s., pyeti: Kush lexonte? Kush është lexuesi? Një njeri u përgjigj dhe tha “unë”, e Pejgamberi a.s. iu kthye: Mendova se dikush do të më shqetësojë!

E transmeton Muslimi. Gjithashtu e transmeton edhe Nesaiu dhe për të ka ndarë një kapitull në vete: Lënia e leximit pas imamit në namazet pa zë.

1.2. Prej Xhabirit r.a. transmetohet se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Kush lidhet pas një imami, leximi i imamit është lexim për të”.

E shënon Hafidhi Ahmed ibn Menii’ në Musnedin e tij, Imam Muhamedi në Muvetta’, Tahaviu në Sherh Meani’l Athar, Darekutnij e të tjerë dhe senedi i tij është sahih.

1.3. Shënohet nga Ibn Omeri r.a. se ka thënë: “Kur të falet dikush prej jush lidhur pas imamit, i mjafton leximi i imamit, e kur të falet vetë le të lexojë. Thotë transmetuesi: Abdullah ibn Omeri nuk lexonte pas imamit.

E ka shënuar Imam Maliku me zinxhir sahih dhe Tahaviu në Sherh Meani’l Athar.

1.4. Prej Vehb ibn Kejsanit përcillet se e ka dëgjuar sahabiun Xhabir ibn Abdullah r.a. duke thënë: “Nuk ka namaz ai që fal qoftë edhe një reqat pa lexuar Fatihanë, përpos nëse falet pas imamit.”

E shënon Maliku, Tahaviu dhe Bejhekiu në el-Kubra dhe senedi i tij është sahih.

1.5. Transmetohet prej Ata ibn Jesarit se e ka pyetur Zejd bin Thabitin r.a. për leximin pas imamit e ai i ka thënë: “Nuk lexohet pas imamit në asnjë namaz”.

E shënon Imam Muslimi në kapitullin e namazit, Bejhekiu në Es-Sunen el-Kubra dhe Ebu Auaneh në Musned.

1.6. Abdullah ibn Meksemi e ka pyetur Abdullah ibn Omerin, Zejd ibn Thabitin dhe Xhabir ibn Abdullahin r.a. për këtë çështje e ata i kanë thënë: “Nuk lexohet pas imamit në asnjërin prej namazave”.

E shënën Tahaviu me sened sahih.

1.7. Ebu Vaili përcjell nga Ibn Mes’udi r.a. se ka thënë: “Qëndro i heshtur kur të lexohet, sepse në të ka diçka (ndonjë urtësi), për këtë të mjafton imami.

E transmeton Imam Tahaviu me sened sahih, Abdurrezaku në Musannef, Taberaniu në el-Mu’xhemu’l-Kebir, Bejhekiu në el-Kubra dhe e ka përmendur Imam Muhamedi në el-Huxhheh. Ibnu’l Hejthemiu ka thënë për transmetimin e Taberaniut se transmetuesit e tij janë të besueshëm.

1.8. Alkameja transmeton nga Ibn Mes’udi r.a. të ketë thënë: “Ju mbushtë goja me dhe (truall) atij që lexon pas imamit!”

Tahaviu me sened hasen, e përcjell gjithashtu Ibn Ebi Shejbeh në Musannef.



1.9. Prej Ebi Xhemres, Imran ed-Dab’ijj, përcillet të ketë thënë: I thashë Ibn Abbasit r.a.: A të lexoj kur jam i lidhur pas imamit? M’u përgjigj: “Jo”.

E transmeton Tahaviu me sened hasen.

1.10. Kethir ibn Murreh transmeton nga Ebi ed-Derdai r.a. të ketë thënë: “U çua në këmbë një njeri dhe pyeti: O i Dërguari i Zotit, a ka lexim Kur’ani në çdo namaz? Ia ktheu: Po. Njëri nga të pranishmit tha; na u bë obligim kjo. Ebu ed-Derdai tha: O Kethir - e mua më kishte krah tij - kur imami i fal një xhemat, iu mjafton atyre leximi i tij”.

E transmeton Darekutnij, Tahaviu dhe Ahmedi, senedi i hadithit është hasen.

Përktheu: **Evzal Sinani**

Përkthyer nga libri: “Argumentet e hanefijve prej hadithe profetike në meselet e fikhut”, Muhammed Abdullah ibn Muslim Behleviu.

NIS SË SHPEJTI RESTAURIMI I XHAMISË HISTORIKE TË PLUMBIT RAMA PRITET NGA MYFTIU I SHKODRËS

Me financim nga qeveria turke, në xhaminë historike të Plumbit, Shkodër, do të nisë së shpejti puna për zbatimin e projektit të restaurimit të thellë si dhe transformimit të krejt mjedisit përreth duke u kthyer besimtarëve një tempull në kushte optimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve e Turqisë do të restaurojë Xhaminë e Plumbit

Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Kulturës, Elva Margariti inspektuan nga afër xhaminë, e cila pas restaurimit do t’i shtojë Shkodrës e Shqipërisë, një tjetër atraksion të madh turistik.

Ata janë pritur dhe shoqëruar nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari.

Ministrja e Kulturës, Elva Margariti, tha se “...I gjithë procesi që po kryejmë me qeverinë turke me departamentin e vakëfeve për gjithë pjesën e rishikimit të projektit të Xhamisë së Plumbit... Pasi nënshkruam marrëveshjen në Turqi për financimin e saj faza e parë ka qenë ajo e rishikimit të projektit që është hartuar më parë në bashkëpunim edhe me Institutin tonë të Monumenteve. Kemi pasur grupin e ekspertëve që kanë ardhur kanë bërë vizitën direkt në terren. Janë bërë të gjitha azhornimet e situatës së gjithë terrenit përreth, pjesa më problematike është në shekuj, sepse nuk është një problem i vonë i përmbytjes së gjithë zonës përreth xhamisë, është rishikuar nga grupi i ekspertëve ka një zgjidhje elegante dhe paksa dinamike. Në pjesën e rrethimit do të ketë një gardh, i cili do të ketë një panel alumini, i cili do të ngrihet në momentin e shtimit të fluksit të shirave dhe ujit dhe do të bëjë të mundur moslejimin e mbushjes së kësaj pjese...”, theksoi Margariti.

Ministrja bëri të ditur se, “Xhamia është ndërtuar në 1773 nga Mehmet Pashë Bushatliu dhe është ndërtuar me gurë lokalë. Për këtë xhami kemi dëshmi edhe nga Eduard Lir, që e ka gjetur me pjesën përreth të përmbytur. Kjo ka ndodhur për shkak të një devijimi të lumenjve Kir dhe Drin që e kanë sjellë gjithmonë në këtë lloj situate”.

Sipas saj, elementët e restaurimit që do të kryhen në xhami janë konservuese, nuk do të ketë tjetërsime dhe nuk do të ketë elementë çimento në ndërhyrje.

“Me ndihmën e ekspertëve gjeologë do të jetë hera e parë që bëjmë një projekt restaurimi të këtij niveli dhe nuk



bazohet vetëm tek monumenti, por në të gjithë territorin përreth. Është një zonë e larmishme me objekte të kultit, kemi një xhami tjetër këtu afër, kemi disa rrënoja arkeologjike. Kjo xhami i përmbahet stilit arkitekturor të arkitekt Sinanit në objektet e kultit në Turqi dhe do t’u rikthehet besimtarëve totalisht funksionale”, tha Margariti.

Ndërsa, kryeministri Rama tha se, “... Kjo ishte një kërkesë që unë e kisha prej kohësh për të mbështetur rindërtimin e thellë të disa xhamive që janë monumente kulture të jashtëzakonshme... Kjo është një nga ato xhami dhe më në fund do të realizohet. Këtu problematika ka qenë e lidhur me gjithë terrenin dhe për këtë është gjetur zgjidhja. Besoj do dalë shumë bukur dhe duhet dhënë një zgjidhje e bukur edhe për pjesën e hapësirës Brenda... Kështu është jeta, erdhi një katolik ja u rregulloi”, – tha Rama.

Kryeministri Rama u shpreh se, “... Në fakt, këtu kam shkel për herë të parë atëherë kur kemi ardhur për meshën që bëri Dom Simoni tek varrezat e Rrmajit. Ishte ai momenti që u angazhuan myslimanë dhe katolikët për të hapur edhe këtë xhami, ishte fantastike fare. Në fakt, që ta dish, shtysa reale është gjysma ime myslimane që kam në shtëpi. Ajo që është vlera më e madhe e shtuar në këto ndërhyrje dhe disa për fat të keq nuk duan të kuptojnë është se përveç se padiskutim komuniteti është përfituesi kryesor, komuniteti i besimtarëve qoftë kur restaurohet një xhami apo kishë, por vlera e shtuar është historia pranë gjeneratave të tjera që fëmijët tanë ta kenë parasysh gjatë gjithë kohës gjithë atë thesarin e trashëgimisë, sepse përtej besimit të drejtpërdrejtë, feja është kulturë dhe histori”, tha Rama.

Kryeministri propozoi që hapësira përreth xhamisë të mbillet me pemët e Kur’anit.

“Do t’iu sugjeroja që në të gjithë pjesën e tokës të konceptohet një park të mbillen të gjitha bimët e kuranit të bëhet një kopsht me të gjitha pemët që përdoren në Kur’an. Sa bukur mund të jetë për fëmijët dhe besimtarët ku të ketë vende për t’u ulur dhe meditimi. Bëhet një park fantastik”, – tha Rama.

Ndërsa, Myftiu i Shkodrës, e falënderoi kryeministrin Rama për vizitën dhe përpjekjen për restaurimin e shumëpritur të xhamisë së Plumbit, sikurse shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan për përkushtimin e shfaqur ndaj kësaj xhamie dhe qëllimit fisnik të bashkëpunimit me qeverinë shqiptare për zbatimin e projektit, që pritet të jetë zgjidhje për problemin e përmbytjes së paevitueshme prej shumë dekadash të kësaj xhamie historike.

Myftiu i tha Kryeministrit Rama se, “Ju duhet të jeni Kryeministri i parë i 100 viteve që shkelni në këtë xhami”...

Myftiu theksoi se xhamia e Plumbit ka një veçori që e dallon nga shumë prej xhamive të vjetra të trashëgimisë islame të Shqipërisë, sepse është ndërtuar sipas arkitekturës arnaute të arkitekturës osmane, në gjurmët e shqiptarit arkitekt Sinani, me famë botërore për kontributet e tij të jashtëzakonshme...

I shoqëruar nga Myftiu i Shkodrës, kryeministri vizitoi edhe gjurmët e xhamisë së vjetër të Qafës, sikurse diskutuan rreth vlerave të mëdha që ka ky kompleks i trashëgimisë islame.

Kujtojmë se protokolli për restaurimin e Xhamisë së Plumbit u nënshkrua nga ministri turk i Kulturës dhe Turizmit, Mehmet Nuri Ersoy dhe ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Elva Margariti, gjatë vizitës së kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama në Turqi më 6-7 janar 2021.

Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve e Turqisë do të restaurojë Xhaminë e Plumbit e tipit osman.

Në kuadër të projektit të restaurimit, do të ndërtohet minarja e Xhamisë së Plumbit, do të rinovohet mbulesa e plumbit, do të realizohen punime suvatimi dhe druri. Gjithashtu synohet të ndërtohet një sistem për parandalimin e përmbytjes së xhamisë.

-Përgatiti për TRT Shqip,
Arben HALLUNI, *Shqipëri*

SOMALIA
REPUBLIKA FEDERALE E SOMALISË

Somalia, ose zyrtarisht "Republika Federale e Somalisë", është një shtet që gjendet në zonën e quajtur Briri i Afrikës, në Afrikë. Ky vend kufizohet me Gjirin e Adenit në veri, me Oqeanin Indian në lindje dhe në jug, me Kenian dhe Etiopinë në perëndim, dhe me Xhibutin në veriperëndim. Somalia është shteti me vijën më të gjatë bregdetare në kontinentin Afrikan, që shkon në një gjatësi totale prej 3.025 kilometrash.

Somalia ka një popullsi prej 16.227.157 banorësh (Mars, 2021), dhe ka një territor me një sipërfaqe prej 637.657 km2.

Kryeqyteti i vendit është **Mogadishu**.

KLIMA

Megjithëse Somalia shtrihet përgjatë Ekuatorit, kushtet klimaterike të saj variojnë nga të thata, në rajonet verilindore dhe qendrore, deri në gjysmë të thata, në veriperëndim dhe në jug. Viti klimatik në Somali i përfshin të katër stinët, dhe sezoni kryesor i shirave, atje, zgjat nga prilli deri në qershor, kurse sezoni i dytë i shirave është nga tetori në dhjetor. Secili nga këto dy sezone shirash pasohet nga një sezon i thatë, ku ai kryesori zgjat nga dhjetori në mars, dhe i dyti, nga qershori deri në shtator. Ndërkohë që zonat bregdetare karakterizohen nga moti i nxehtë dhe i lagësht gjatë gjithë vitit, pjesa e brendshme e vendit ka një klimë të thatë dhe të nxehtë.

Somalia i ka temperaturat mesatare vjetore ndër më të lartat në botë. Në qytetin Berbera, në bregdetin verior, temperatura mesatare e pikut të ditës, nga qershori deri në shtator, është rreth 38°C. Temperaturat maksimale në brendësi të vendit janë edhe më të larta, ndërkohë që, përgjatë bregut të oqeanit Indian, temperaturat janë dukshëm më të ulëta, për shkak të një rryme të ftohtë detare në atë zonë.

GJUHA

Gjuha e parë zyrtare në vend është gjuha somaleze, e cila është një nga gjuhët Kushitike, që përfaqëson një degëzim të familjes së gjuhëve Afro-Aziatike.

Gjuha e dytë zyrtare në Somali, është arabishtja, e cila flitet kryesisht në Somalinë veriore dhe në qytetet bregdetare. Për shkak të së kaluarës koloniale të Somalisë, shumë banorë të saj i zotërojnë mirë anglishten dhe italishten, gjuhë të cilat, përveç somalishtes, përdoren në kolegjet dhe universitetet e vendit. Suahilishtja, gjithashtu, flitet në jug të vendit. Në vitin 1973, Somalia miratoi një drejtshkrim zyrtar, bazuar mbi alfabetin latin (deri në atë kohë, gjuha Somaleze ka qenë një gjuhë e pashkruar).

FEJA

Sipas Qendrës Kërkimore "Pew Research Center", 99.8% e popullsisë së Somalisë janë myslimanë, nga të cilët shumica i përkasin Islamit Sunit, që ndjekin shkollën Shafi të Jurisprudencës Islame; një pjesë e vogël e popullsisë janë sufistë. Kushtetuta e Somalisë e cilëson Islamin si feja shtetërore e Republikës Federale të Somalisë, dhe Legjislacionin Islam të Sheriatit e cilëson si burimin themelor për legjislacionin kombëtar. Kushtetuta e Somalisë përcakton gjithashtu që, asnjë ligj që është në kundërshtim me parimet themelore të Sheriatit, nuk mund të miratohet.

EKONOMIA

Në antikitet, Somalia ka qenë një qendër e rëndësishme tregtare, dhe me shumë mundësi është vendi ku dikur ka qenë toka e Puntëve. Gjatë Mesjetës, disa perandori të fuqishme somaleze kanë dominuar tregtinë rajonale, përfshirë Sulltanatin Axhuran, Sulltanatin Adal dhe Sulltanatin e Geledit.

Kohëve të fundit, rreth tre të pestat e ekonomisë së Somalisë bazohen në bujqësi dhe blegtori, por aktiviteti kryesor ekonomik nuk janë fermat bujqësore, por rritja e bagëtive. Midis viteve 1969 dhe fillimit të viteve 1980, qeveria ushtarake e Muhamed Siad Barre, në Somali, imponoi një sistem të "Socializmit Shkencor", i cili karakterizohej nga shtetëzimi i bankave, firmave të sigurimeve, kompanive të naftës dhe firmave të mëdha industriale, nga krijimi i ndërmarrjeve shtetërore, fermave dhe ndërmarrjeve tregtare, dhe organizimi i kooperativave të kontrolluara nga shteti. Në fund, ky eksperiment e dobësoi ekonominë somaleze në mënyrë të konsiderueshme dhe, që nga rënia e regjimit ushtarak, ekonomia ka vuajtur edhe më shumë për shkak të luftës civile.

Megjithatë, Somalia arriti të ndërtojë një ekonomi në rritje në vitet e fundit, të bazuar kryesisht në blegtori, kompanitë e transferimit të parave dhe kompanitë e telekomunikacionit. Në vitin 2003, rritja e sektorit privat ishte e jashtëzakonshme, veçanërisht në fushat e tregtisë, transportit, transferimit të parave dhe shërbimeve të infrastrukturës, përveç prosperitetit që kishte arritur në sektorë të tillë si blegtoria, bujqësia dhe peshkimi.


Kryeqyteti Mogadishu, 1936

HISTORI

Sipas evidencave, zona ku sot gjendet Somalia, ka qenë e banuar që nga periudha paleolitike. Gjatë epokës së gurit, aty lulëzuan kulturat Doiane dhe Hargeisane.

Strukturat e lashta piramidale, mauzoleumet, qytetet e shkatërruara dhe muret prej guri, të tilla si Muri Ëargade, janë dëshmi e një civilizimi të vjetër që kishte lulëzuar dikur në gadishullin e Somalisë.

Në epokën klasike, Makrobianët, për të cilët thuhet se janë paraardhësit e Somalezëve të sotëm, krijuan një mbretëri të fuqishme fisnore që sundonte pjesë të mëdha të Somalisë moderne. Makrobianët ishin luftëtarë, barinj dhe lundërtarë, dhe ishin të përmendur për jetëgjatësinë dhe pasurinë e tyre, dhe thuhet se ishin "më të gjatë dhe më të bukur nga të gjithë njerëzit". Makrobianët ishin një fuqi rajonale me reputacion për arkitekturën e tyre të përparuar, dhe për pasurinë e tyre në ar, e cila ishte aq e bollshme saqë thuhet se edhe të burgosurit e tyre i prangosnin me zinxhirë të artë.

Somalia ka qenë një qendër e rëndësishme tregtare në botën antike. Gjatë Mesjetës, disa shtete të fuqishme somaleze dhe qytete porte, si Sulltanati Mogadisho dhe Sulltanati Axhuran, ku të dy ishin të përqendruar rreth qytetit port Mogadisho, por edhe qytetet porte të Baraë dhe Merka, e dominuan tregtinë rajonale.

NË KOHËT E LASHTA

2350 p.e.s: Toka e Punt-ëve krijon tregti me egjiptianët e lashtë.

Shekulli i Parë, pas Isait (a.s): Qytetet-shtet në bregdetin e Somalisë ishin aktive në tregtinë me grekët, dhe më vonë me romakët.

Zhvillimet e Epokës Islame në Somali:

Vitet 700 - 900: Somalezët përqafojnë Islamin.

Shekulli 9 - Shekulli 13: Mbretëria Adal.

Shekulli 10 - Shekulli 16: Sulltanati i Mogadishut.

1285 - 1415: Ngritja dhe rënia e Sulltanatit Ifat.

1200 - fundi i 1600: Ngritja dhe rënia e Sulltanatit Axhuran.

1415 - 1559: Ngritja dhe rënia e Sulltanatit Adal.

1528 - 1535: Xhihadi kundër Etiopisë, i udhëhequr nga Ahmed ibn Ibrahim El-Ghazi

Mesi i shekullit të 18-të - 1929: Sulltanati Maxhirtín

1878 - 1927: Sulltanati i Hobio-s.

Në Epokën Moderne, në fund të shekullit të 19-të, përmes traktatesh të njëpasnjëshme me këto mbretëri, britanikët dhe italianët fituan kontroll mbi pjesët e bregdetit, dhe krijuan Somalilandin Britanik dhe Somalilandin Italian. Në pjesët jugore të Somalisë, italianët zhvilluan një luftë me somalezët rreth qytetit port Merka, ku hasën në atë që u quajt Rezistenca e Banadir-it. Në pjesët veriore, Muhammed Abdullah Hassan, me lëvizjen Dervishe, e zmbrapsi me sukses katër herë Perandorinë Britanike, dhe e detyroi atë të tërhiqej në rajonin bregdetar, por në vitin 1920, Dervishët u mundën përfundimisht nga forcat ajrore Britanike.

Në këtë kohë, Italia zhvilloi me sukses Fushatën e Sulltanateve, kundër Sulltanatit Maxhirtín dhe Sulltanatit Hobio, dhe fitoi kontrollin e plotë të pjesëve verilindore, qendrore dhe jugore të territorit. Ky pushtim zgjati deri në vitin 1941, kur u zëvendësua nga një administratë ushtarake britanike. Somalia Veriperëndimore do të mbetej një protektorat, ndërsa Somalia verilindore, qendrore dhe jugore, me 1 prill të vitit 1950, do të hynin me marrëveshje nën kujdestarinë e Kombeve të Bashkuara, me premtimin të merrnin pavarësinë pas 10 vitesh.

Më 1 Korrik të vitit 1960, të dy rajonet e Somalisë u bashkuan, siç ishte planifikuar, për të formuar Republikën Somaleze të pavarur, të drejtuar nga një qeveri civile. Asambleja Kombëtare e Somalisë, e kryesuar nga Haxhi Bashir Ismail Jusuf, miratoi aktin që bashkonte ish Somalilandin Italian me Somalilandin Britanik, dhe kështu u themelua Republika e Somalisë.

SI HYRI ISLAMI NË SOMALI

Historia e Islamit në Briri e Afrikës, nis që nga fillimet e para të lindjes së kësaj feje të re në gadishullin Arabik. Kontakti i muslimanëve me këtë rajon të botës, filloi me emigrimin e parë të muslimanëve që u detyruan të iknin nga shtypja e kurejshitëve. Ata zbarkuan në portin e Zeila-s, që ndodhet në veri të tokave somaleze, zonë e cila asokohe ishte pjesë e Mbretërisë Abisinase. Ata muslimanë kërkuan mbrojtje nga Nexhashiu (As'hama ibn Eb'har), mbreti i Abisinisë, i cili u dha atyre siguri për jetën, dhe të drejtën për të qëndruar të lirë në vendin e tij. Ata muslimanë që qëndruan atje, u përhapën në pjesë të ndryshme të Bririt të Afrikës, dhe punuan për përhapjen e fesë Islame në vend.

* * *

Kur Profeti Muhammed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, po shikonte shtypjen që u bëhej ndjekësve të tij në Mekë, ai i urdhëroi ata të emigronin në një vend të sigurt, në Etiopinë Veriore, në Abisini.

Nëna e besimtarëve, Ummu Seleme

12

Xhamia Isbahaysiga (Solidariteti)
Mogadishu, Somali

(r.a), e përshkruan kështu këtë ngjarje, dhe thotë: “Meka u bë shumë e ngushtë për ne, dhe shokët e të Dërguarit të Zotit (a.s) po keqtrajtoheshin, po sprovoheshin me vështirësi dhe po pengoheshin nga feja e tyre. I Dërguari i Allahut (a.s), mbrohej nga xhaxhai i tij dhe nga fisi i tij, e nuk haste në të tilla probleme, por ai nuk mund të bënte asgjë për shokët e tij, prandaj u tha atyre: “Në Abisini është një mbret, pranë të cilit nuk i bëhet padrejtësi askujt, prandaj, shkoni atje në vendin e tij, derisa Allahu t’ju bëjë çlirim dhe rrugëdalje nga kjo gjendje në të cilën ndodheni!”... Kështu që ne, – thotë Ummu Seleme - dolëm për atje në grupe, derisa u mblodhëm në atë vend... dhe vërtetë, zbritëm në vendin më të mirë, tek fqinji më i mirë, i cili na dha siguri për fenë tonë, dhe nuk kishim frikë se do të na bënte padrejtësi.” - [Transmeton Bejhakiu]

Nëna e besimtarëve, Ummu Seleme (r.a), vazhdon të na tregojë se çfarë u ndodhi atyre më tej, pasi shkuan në Abisini: “Kur zbritëm në tokën e Abisinisë, ne ishim aty pranë komshiut më të mirë, pranë Nexhashiut, i cili na siguroi për fenë tonë, dhe ne adhuruam Allahun e Madhëruar, pa na lënduar askush, as dëgjonim ndonjë gjë që nuk na pëlqente.

Kur kurejshitët morën vesh për këtë, ata thurën plane të dërgonin dy burra të fortë, të ngarkuar me dhurata për Nexhashiun, dhurata që konsideroheshin të rralla nga Mekasit dhe e dinin se Nexhashiut më së shumti i pëlqenin lëkurat, kështu që ata mblodhën shumë lëkura... dhe nuk lanë as patriark nga patriarkët atje, pa i caktuar një dhuratë. Pastaj, ata caktuan Abdullah ibn Ebi Rabia dhe Amër ibnul-As dhe i dërguan me këto dhurata, e i urdhëruan këta të dy me këto fjalë: “Para se të flisni me Nexhashiun për këtë punë, jepjani secilit patriark dhuratën e tij... pastaj afrojani edhe Nexhashiut dhuratat e tij, e më pas kërkojini atij t’jua dorëzojë ata njerëz, para se ai të flasë me ta!”

Ummu Seleme (r.a) vazhdon: “Ata të dy nuk kishin lënë patriark pa ia dhënë dhuratën e caktuar për të, para se të flisnin me Nexhashiun, dhe i kishin thënë secilit: “Në tokat e mbretit kanë ardhur një grup djemsh të pamend, të cilët e kanë lënë fenë e popullit të tyre, as kanë hyrë në fenë tuaj, por kanë nxjerrë një fe të shpikur të cilën nuk e njohim ne, as ju. Neve na kanë dërguar për këtë çështje njerëzit më të nderuar të popullit të tyre, që t’i kthejmë ata, e kur të flasim me mbretin për këtë çështje, ju sugjerojini atij të na i dorëzojë, dhe të mos flasë aspak me ta, sepse populli i tyre e dinë më mirë se pse i fajësojnë!” Dhe patriarkët u kishin thënë që: “Po, në rregull!”

Pastaj ata të dy ia ofruan dhuratat e tyre Nexhashiut dhe ai i pranoi ato, e më pas ata të dy thanë: “O Mbret, në tokën tënde kanë ardhur një grup djemsh të pamend, të cilët e kanë lënë fenë e popullit të tyre, as kanë hyrë në fenë tuaj, por kanë nxjerrë një fe të shpikur që nuk e njohim ne, as ju. Neve na kanë dërguar për këtë çështje njerëzit më të nderuar të popullit të tyre, baballarët, axhallarët dhe fiset e tyre, që t’i kthesh ata tek ta, dhe populli i tyre e dinë më mirë se pse i kanë fajësuar dhe qortuar ata!”

Ummu Seleme (r.a) vazhdon: Nuk kishte gjë më të urryer për Abdullah ibn Ebi Rabia dhe Amër ibnul-As sesa që Nexhashiu të dëgjonte fjalët e tyre.

Pasi që ata të dy kishin folur, patriarkët kishin thënë: Të vërtetën po thonë, o mbret! Populli i tyre e dinë më mirë se pse i fajësojnë, prandaj dorëzojua ata këtyre të dyve, t’i kthejnë në vendin e tyre, tek populli i tyre!

Nexhashiu ishte zemëruar dhe kishte thënë: Jo, për Zotin, unë nuk i dorëzoj ata dhe nuk i tradhtoj ata njerëz që kanë ardhur të jetojnë pranë meje, që kanë ardhur në vendin tim, e më kanë zgjedhur mua mbi të tjerët! Unë nuk i dorëzoj ata pa i thirrur dhe t’i pyes rreth kësaj që këta të dy thonë për ta! E nëse janë siç thonë këta të dy, atëherë ua dorëzoj këtyre dhe i kthej tek populli i tyre... e nëse janë ndryshe, unë i ndaloj ata prej këtyre të dyve dhe do të sillem mirë me ta, për sa kohë të qëndrojnë pranë meje!

Ummu Seleme (r.a) vazhdon të tregojë: Pastaj ai kishte dërguar dikë t’i thërriste ndjekësit e të Dërguarit të Allahut (a.s). E kur atyre u erdhi i dërguari i mbretit, ata u mblodhën, dhe thanë me njëri-tjetrin: “Çfarë do t’i thoni atij burri kur të shkoni tek ai?”... E një pjesë e tyre thanë: “Për Zotin, ne do të themi atë që dimë dhe çfarë na ka urdhëruar Profeti jonë, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të... e të bëhet çfarë të bëhet!”

Dhe kur erdhën atje, ndërkohë që Nexhashiu kishte thirrur peshkopët e tij dhe ata kishin hapur librat e tyre rreth tij, për t’i pyetur ata, Nexhashiu u tha: Çfarë është kjo fe, për shkak të së cilës ju jeni ndarë nga populli juaj dhe nuk keni hyrë në fenë time, e as në fenë e asnjërit nga këta popuj rreth e rrotull?!

Ummu Seleme (r.a) tregon: Nga mesi i muslimanëve doli të flasë Xhafer ibn Ebi Talib, dhe tha: “O Mbret, ne kemi qenë një popull injorant, që adhuronim idhujt, hanim gjënë e ngordhur, bënim gjëra të shëmtuara, i shkëpusnim lidhjet farefisnore, robëronin femrat, i forti nga ne e hante të dobëtin... dhe ishim në këtë gjendje, deri kur Allahu na dërgoi një të Dërguar nga vetë mesi ynë, të cilit ia dimë prejardhjen, sinqeritetin, besnikërinë dhe dëlirësinë e tij.

Ai na ftoi tek Zoti, që ta njohim Atë si Një dhe të Vetëm, ta adhurojmë Atë dhe të largohemi nga idhujt e statujat prej guri e druri që i adhuronim ne dhe baballarët tanë. Ai na urdhëroi të flasim të vërtetën, ta ruajmë dhe ta mbajmë amanetin, t’i mbajmë lidhjet farefisnore, të jemi të mirë me komshiun, të përmbahemi nga gjërat e ndaluara dhe nga gjakderdhja... na

ndaloi nga imoraliteti, nga fjala e rreme, nga ngrënia e pasurisë së jetimit, nga përgojimi i grave, dhe na urdhëroi të adhurojmë Allahun, vetëm Atë, e të mos i shoqërojmë asgjë Atij në adhurim... e na urdhëroi të falim namazin, të japim zekatin, të mbajmë agjërimin (dhe i renditi atij çështjet e Islamit).

Ne i besuam atij, dhe i ndoqëm ato mësime që ai na i solli nga Allahu, dhe adhuruam Allahun, të Vetëm, e nuk i shoqëruam asgjë Atij... ndaluam nga ajo që Ai na e ndaloi, dhe e lejuam atë që na e lejoi. Por, populli jonë na trajtuan padrejtësisht, na torturuan, na penguan nga feja jonë, për të na kthyer tek adhurimi i idhujve, për të na larguar nga adhurimi i Allahut të Plotfuqishëm, dhe për të lejuar rishtazi ato ndytësi që i lejonim më parë. Dhe kur na shtypën, na bënë padrejtësi, na e vështirësuan jetën dhe na penguan nga feja jonë, ne erdhëm në vendin tënd dhe të zgjodhëm ty ndaj gjithë të tjerëve, dëshiruam të qëndrojmë pranë teje dhe shpresuam të mos na bëhet padrejtësi këtu tek ti, o mbret!”

Ummu Seleme (r.a) thotë: Nexhashiu i tha: “A ke me vete ndonjë gjë nga ajo që ai (Profeti) ka sjellë nga Allahu?”. Xhaferi i tha: “Po!” Nexhashiu i tha: “Ma lexo!”. Dhe Xhaferi lexoi një pjesë nga fillimi i sures Merjem: “Keef-He-Je-Ajn-Sād* ...”. Ummu Seleme (r.a) tregon: Dhe Nexhashiu, për Zotin, qau derisa iu njom mjekra... dhe qanë edhe peshkopët e tij derisa i njomën me lot librat e tyre kur dëgjuan atë që u lexoi ai. Pastaj Nexhashiu tha: Vërtetë, kjo dhe ajo me të cilën ka ardhur Musai, buron nga një Dritë e vetme! Ikni (u tha atyre të dyve), se për Zotin nuk jua dorëzoj kurrë këta njerëz dhe as nëpër mend nuk më shkon një gjë e tillë!

Ummu Seleme (r.a) thotë: Kur dolëm prej tek ai, Amru ibnul-As tha: Për Zotin, nesër unë do t’i tregoj atij për gjënë më të keqe që këta kanë, e do t’i nxjerr ata nga rrënjët!”. Abdullah ibn Rabia, i cili ishte një njeri nga më të ndershmit, i tha: “Mos e bëj këtë, sepse këta janë gjaku ynë, edhe nëse janë në konflikt me ne!” Dhe ai ia ktheu: “Për Zotin, unë do t’i tregoj atij se këta pretendojnë se Isai i biri i Merjemes (paqja qoftë mbi të dhe mbi nënën e tij), është thjeshtë një rob”.

Ajo tregon: Pastaj erdhi e nesërmja, dhe ai i tha: “O Mbret, ata thonë një fjalë të rëndë për Isain, birin e Merjemes!”

Mbreti dërgoi dhe i thirri, dhe i pyeti se çfarë thonë ata për të. Dhe Ummu Seleme (r.a) tregon: “Ne u ndjemë shumë keq! U mblodhën të gjithë, dhe po i thoshin njëri-tjetrit: “Çfarë do të thoni për Isain, kur t’ju pyesë për të?”. Dhe thanë: “Për Zotin, ne do të themi për të, atë që ka thënë Allahu - i Madhëruar dhe Lartësuar qoftë Ai - dhe atë që na ka thënë Profeti ynë - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të - e pastaj të bëhet çfarë të bëhet!”

Parkuk kombëtar - Kismayo, Somali

Dhe kur hynë tek ai, ai u tha: “Çfarë thoni ju për Isain, birin e Merjemes?”

Foli Xhafer ibn Ebi Talib, dhe tha: “Ne themi për të, atë që na ka thënë Profeti ynë - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të - se ai është robi i Zotit dhe i Dërguari i Tij, dhe shpirti i Tij, dhe fjala e Tij që ia hodhi Merjemes së virgjër, e cila nuk është martuar kurrë”.

Ummu Seleme (r.a) tregon: Nexhashiu i ra tokës me dorën e tij, mori një shkop prej saj, pastaj tha: “Kjo që the ti, nuk e tejkalon të vërtetën për Isain, birin e Merjemes, as sa ky shkop.”

Peshkopët përreth tij filluan të flasin kur tha atë që tha, dhe ai u tha: “Edhe nëse flitni!!”. Pastaj u tha Xhaferit me shokë: “Shkoni, se për Zotin, ju do të jeni të sigurt në tokën time! Kushdo që ju fyen, do të gjobitet! Kushdo që ju fyen, do të gjobitet! Kushdo që ju fyen, do të gjobitet!... Unë nuk e dua të kem një mal me ar, dhe në këmbim të lëndoj një njeri prej jush!” Pastaj tha: “Kthejuani atyre të dyve dhuratat e tyre, sepse nuk kemi nevojë për to! Sepse, për Zotin, Zoti nuk mori rryshfet prej meje kur ma ktheu mbretërinë time, që të marr unë rryshfet për Të... as dëgjoi njerëzit Ai kur më zgjodhi mua, që t’i dëgjoj unë ata e t’u bindem për çështje që kanë të bëjnë me Të!”

Ummu Seleme (r.a) thotë: “Dhe ne dolëm prej tek ai, ndërkohë që ata të dy ishin tashmë të poshtëruar dhe iu refuzuan ato me të cilat patën ardhur... Ne qëndruam tek ai, dhe ai vend ishte vendi më i mirë për ne, e ishim pranë më të mirit komshi!

Dhe ajo vazhdon: Për Zotin, kështu vazhduam të jetojmë atje, derisa filluan trazira në mbretërinë e tij, dhe për Zotin nuk kemi njohur hidhërim më të madh sesa atë kohë kur atij po i kërcënohej pushteti, nga frika se mos mposhtej Nexhashiu, dhe të vinte në vend të tij ndonjë burrë që nuk do të na e njihte të drejtën siç na e njohu Nexhashiu...

Nexhashiu më pas kishte ndryshuar seli, dhe mes nesh dhe atij ishte lumi i Nilit. Shokët e të Dërguarit të Allahut - paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të – thanë: “Cili është ai burrë që del e merr vesh se çfarë ka ndodhur me këta njerëz, e të na sjellë lajmin?”. Doli Zubejr ibnul-Avam (r.a) dhe tha: “Unë.”, dhe ai ishte më i riu në moshë... Ata i frynë një lëkurë kafshësh dhe ai e vendosi atë në gjoks, pastaj notoi mbi të, derisa doli në anën tjetër të Nilit, ku mblidheshin njerëzit, dhe shkoi tek ata për të mësuar se çfarë kishte ndodhur.

Ndërkohë, ne i luteshim Allahut të madhërishëm ta nxirrte fitimtar Nexhashiun kundër armikut, dhe ta fuqizonte atë në vendin e tij. Dhe vërtetë, çështja e Abisinisë iu besua atij, kështu që ne qëndruam tek ai, vend i cili për neve që një vend shumë i mirë, derisa erdhëm tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ndërsa ai ishte në Mekë.” - [Transmeton Imam Ahmedi]

Kjo histori që e tregon nëna e besimtarëve Ummu Seleme (r.a), përfaqëson hixhretin e parë që muslimanët patën bërë për hir të fesë... Siç tregon ajo, ky vend ku sot është Somalia, i priti me derën hapur besimtarët, dhe kjo ngjarje do të mbetet përgjithmonë si një faqe e ndritur në historinë e Somalisë.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.worldometers.info
https://www.britannica.com
https://ar.wikipedia.org
https://en.wikipedia.org

MYFTIU TAKOI IMAMËT E ZONËS POSTRIBË

Paraditën e së hënës, më 1 mars 2021, në kuadër të bashkëbisedimeve me imamët, në kuadër të Tre Muajve të Mirë 1442, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e zonës Postribë.

Gjatë takimit, u diskutua mbi problematikat e shumta që ka zona, komuniteti i besimtarëve, aktivitetet bamirëse, zhvillimi i jetës fetare dhe ruajtja e traditave shekullore.

Myftiu foli edhe mbi rëndësinë që ka shfrytëzimi i ditës së xhuma për përcjelljen e mesazheve të urta, larg ligjërimeve pa dobi, larg realiteteve të jetuara dhe nevojave të komunitetit.

Myftiu dëgjoi me vëmendje edhe sugjerimet dhe shqetësimet e imamëve të kësaj zone, ku të gjithë ishin të mendimit se Postriba ishte dhe mbeti e persekutuar dhe larg vëmendjes së institucioneve, si në komunizëm, ashtu edhe në këto 30 vite që pasuan periudhën më të errët të historisë sonë kombëtare.

U vu theksi tek mungesa e investimeve, varfëria që detyron

banorët e Postribës të largohen nga vendlindja, e shumë problematika që shqetësojnë besimtarët e kësaj zone të begatë.

U diskutuan mendimet dhe shqetësimet e imamëve të xhamive: Omaraj, Dragoç, Boks, kala e Drishtit dhe Drisht, Fshati i Ri, etj.

MYFTIU TAKOI IMAMËT E ZONËS GURI I ZI

Paraditën e së martës, më 2 mars 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e zonës Guri i Zi.

Takimi, që vjen në kuadër të Tre Muajve të Mirë, ka për qëllim edhe diskutimin e problematikave të ndryshme që kanë komunitetet muslimane të zonave tona, si dhe trajtimin e tyre për të arritur në zgjidhjen e shqetësimeve.

Në fjalën e tij, Myftiu kërkoi nga imamët që të shfrytëzohet kjo periudhë për afrimin e besimtarëve me xhaminë dhe moralin islam, si dhe nxitjen e solidaritetit dhe harmonisë në mesin e tyre.

Myftiu dëgjoi shqetësimet dhe mendimet e imamëve të xhamive: Shtoj i Ri, Vukatanë, Guci e Re, Bardhaj, Ganjollë, etj., të cilët ngritën edhe problemin e pazgjidhur me mbifaturimet e energjisë elektrike, me të cilin përballen xhamitë tona, nevojën e ndërhyrjes për meremetimin e disa xhamive dhe shtimin e tyre me objekte shtesë, që lehtësojnë aktivitetin, si: qendra kulturore, kënde sportive, kënde lojrash për fëmijët, çerdhe dhe kopshte, etj.

Pas takimit me imamët e zonës, Myftiu, i shoqëruar edhe nga një grup imamësh, fali namazin e mesditës në xhaminë e Ganjollës.

MYFTIU TAKOI IMAMËT E ZONËS BUSHAT

Paraditën e së mërkurës, më 3 mars 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e zonës Bushat, me të cilët diskutoi rreth problematikave të aktivitetit dhe dha mesazhin e tij me rastin e fillimit të Tre Muajve të Mirë.

Myftiu informoi imamët me iniciativën e ndërmarrë, për të takuar imamët e krejt zonave, ku përveç udhëzimeve dhe mesazheve, trajtohen edhe shqetësimet e ndryshme të imamëve tanë.

Imamët e xhamive: Barbullush, Bushat, Rrushkull, Shirq, Krye-Bushat, Luarëz, etj., shfaqën shqetësimet e tyre, që lidhen kryesisht me infrastrukturën dhe neglizhencën e autoriteteve ndaj zonave me banorë muslimanë, ndër dekada, ku akoma sot, në vitin 2021, nuk ka rrugë të shtruara e të ndriçuara, që lidhin lagjet me xhaminë.

Myftiu theksoi se realitete të tilla janë të papranueshme dhe dëshmi e një frymë të keqe, prej së cilës vendi duhet pastruar dhe, së bashku me të edhe mendësia e trajtimit të projekteve madhore mbi bazën e kapriçove dhe tendencave me nuancë fetare, ç'ka është evidente në Shkodrën e pas vitit 1990.

Myftiu dha udhëzimet e tij edhe në lidhje me ligjërimin fetar dhe shfrytëzimin e hytbes së xhumasë për sensibilizimin e masave me frymën e besimit dhe dinjitetit islam.

Myftiu dhe imamët e pranishëm vizituan edhe xhaminë e Bushatit dhe qendrën islame atje, ku falën së bashku edhe namazin e mesditës.

MYFTIU TAKOI IMAMËT E ZONËS ANA E MALIT

Paraditën e së enjtes, më 4 mars 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi imamët e zonës Ana e Malit, me të cilët diskutoi rreth aktivitetit dhe problematikave të jetës fetare e sociale.

Myftiu falënderoi imamët për përkushtimin e tyre në ruajtje të frymës së vëllazërisë dhe harmonisë islame, si dhe udhëzoi ruajtjen e traditave islame dhe përqendrimin tek brezi i ri dhe sfidat e edukimit.

Imamët e xhamive: Xhaferraj, Alimetaj, Velinaj, Zues, Shirokë, etj., shfaqën shqetësimet dhe mendimet e tyre në lidhje me aktivitetin dhe nevojat që ka zona dhe besimtarët.

U vlerësua roli i imamëve të Anës së Malit në gjendjen e tyre pranë njerëzve, në të mirë e në të keq, duke u dëshmuar si prijës të urtë dhe udhërrëfyes në shërbim të komunitetit.

NIS FUSHATA E RE E RREGULLIMIT TË BAHÇEVE TË XHAMIVE

Nën përkujdesjen plot përkushtim të mirëmbajtësit të xhamive, Haxhi Denis Tula, një punë e mirë dhe me dobi për pastrimin e pemëve dhe çinarit, sapo nisi në lulishten e xhamisë së Tophanës!

Ardhja e Muajit Ramazan, na frymëzon për të punuar me të gjitha mundësitë për përgatitjen e xhamive, bahçeve dhe ambienteve të tyre për të shijuar këtë bekim të madh hyjnor që është nisur drejt nesh!

Bëhuni pjesë e kësaj tradite shekullore, që duhet ta ruajmë e ta përcjellim edhe tek brezi i ri: Të bëhemi gati me pastrim të jashtëm e të brendshëm, të dukshëm e të fshehtë, për pritjen e Muajit që na mbush me dritë e shpresë, na sjell mëshirë e falje, që Zoti i gjithësisë ka premtuar për besimtarët!

Allahu e begatoftë!

PËRKUJTOHET NATA E MADHE E ISRASË DHE MIRAXHIT

Mbarë bota islame kremtoi të mërkurën, më 10 mars 2021, Natën e Madhe të Israsë dhe të Miraxhit.

Edhe në Shqipëri u përkujtua Nata e Mirë, ku në xhamitë e ndryshme, edhe pse në kushte të vështira pandemie u bënë dua-lutje, programe fetare, këndime ilahi dhe salavate.

Ndërsa, në metropolin verior, në Shkodër, Myftinia e kësaj zone zhvilloi në xhaminë e Parrucës, pas iqindisë aktivitetin me temë:"Në përkujtim të mrekullisë së Israsë dhe Miraxhit".

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, para të pranishmeve dha mesazhin e vendosjes së paqes, harmonisë dhe barazisë sociale në çdo vend të botës.

Myftiu kërkoi prej besimtarëve që të dëshmojnë mëshirën me njeri-tjetrin, të ruajnë dinjitetin dhe Islamin që Zoti ka krenuar këtë ummet deri në ditën e fundit...

Myftiu i Shkodrës, në fund të mesazhit të tij u lut për të gjithë ata besimtarë që kanë kaluar në jetën tjetër të amshuar, që Zoti t'i mëshirojë, sidomos në këto tre muaj të mirë të besimit, Rexhep, Shaban dhe zotëria i krejt muajve, muaji i bekuar i Ramazanit...

Më pas, imamët Lavdrim Hamja, Naim Drijaj dhe Durim Kasemi folën për rëndësinë dhe vlerën e madhe që mbart ngjarja dhe mrekullia e Israsë dhe Miraxhit.

MYFTIU: "XHAMIA E PLUMBIT, GJURMË E TRASHËGIMISË ARNAUTE TË ARKITEKTURËS OSMANE"

Paraditën e së enjtes, më 18 mars 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në ambientet e xhamisë së Plumbit, kryeministrin e Shqipërisë, ShTZ. Edi Rama.

Kryeministri Rama vizitoi xhaminë shekullore, simbol i rimëkëmbjes së vlerave islame tradicionale në Shqipëri, vendin ku 30 vite më parë, më 16 nëntor 1990, u zhvillua edhe ceremonia madhështore e të xhumasë së parë masive në Shqipërinë e drobitur nga ndalimi me ligj i fesë që në vitin 1967.

Myftiu e falënderoi kryeministrin Rama për vizitën dhe përpjekjen për restaurimin e shumëpritur të xhamisë së Plumbit, sikurse shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për presidentin e Turqisë, ShTZ. Rexhep Taip Erdogan për përkushtimin e shfaqur ndaj kësaj xhamie dhe qëllimit fisnik të bashkëpunimit me qeverinë shqiptare për zbatimin e projektit, që pritet të jetë zgjidhje për problemin e përmbytjes së paevitueshme prej shumë dekadash të kësaj xhamie historike.

Myftiu theksoi se xhamia e Plumbit ka një veçori që e dallon nga shumë prej xhamive të vjetra të trashëgimisë islame të vendit, sepse është ndërtuar sipas arkitekturës arnaute të arkitekturës osmane, në gjurmët e shqiptarit arkitekt Sinani, me famë botërore për kontributet e tij të jashtëzakonshme.

I shoqëruar nga Myftiu i Shkodrës, kryeministri vizitoi edhe gjurmët e xhamisë së vjetër të Qafës, sikurse diskutuan rreth vlerave të mëdha që ka ky kompleks i trashëgimisë tonë islame.

MYFTINIA SHKODËR DHE SHOQATA "ISTANBUL" NDIHMOJNË BANORËT E ZONAVE SHIRQ-MUSHAN DHE LUARZ

Paraditën e të shtunës, më 20 mars 2021, Myftinia Shkodër me mbështetjen e shoqatës "Istanbul" organizoi shpërndarjen e radhës të 120 pakove me ushqime për fshatrat Shirq-Mushan të Njësisë Administrative Dajç si dhe rreth 80 pako për fshatin Luarz të Njësisë Administrative Velipojë, të prekur nga përmbytjet e fundit në zonën e Nën-Shkodrës.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni gjatë një përshëndetjeje para banorëve të këtyre dy zonave tha se këto ndihma për familjet e prekura nga përmbytje e fundit, kanë për qëllim të lehtësojnë sadopak situatën e tyre të vështirë përballë kësaj sprovë, si dhe për të shprehur frymën e solidaritetit në çdo situatë pa dallim besimi, krahine dhe prejardhjeje.

Teologu Halluni falënderoi shoqatën e mirënjohur "Istanbul", kryetarin e saj, që ishte i pranishëm në këtë veprimtari humanitare, z. Ridvan Seferaj, që iu përgjigjën thirrjes së Myftinisë Shkodër për të ndihmuar disa zona të prekura nga përmbytjet në këtë situatë të vështirë pandemie.

Kujtojmë, se Myftinia Shkodër gjatë përmbytjeve të fundit në Shkodër dhe pas saj ka organizuar shpërndarje ndihmash të ndryshme në bashkëpunim me partnerët e saja në fshatrat: Rrushkull, Belaj, Samrish, Goricë, Muriqan, Oblikë, Velinaj, Alimetaj, Shirq-Mushan dhe Velipojë.

MYFTINIA ORGANIZOI AKTIVITETIN "POZITA DHE RËNDËSIA E XHAMISË NË ISLAM"

Ditën e martë, më 23 mars 2021, në xhaminë e Parrucës, pas namazit të iqindisë, me rastin e 14 vjetorit të përurimit të xhamisë së Parrucës: 23 mars 2007 - 2021, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin me temë: "Pozita dhe rëndësia e xhamisë në Islam".

Krahas besimtarëve të moshave të ndryshme, merrnin pjesë imamë, teologë, etj.

Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Shkodrës në ligjërimin e tij, ndër të tjera tha: "Dita e sotme përkujtimore nuk është një ngjarje e zakonshme, sepse para 14 viteve kjo qendër e madhe shpirtërore është rindërtuar para 14 viteve në të njëjtën vend dhe në të njëjtën pozitë, ku 40 vite më përpara u prish dhe u shkatërrua nga ata që nuk besojnë në Zot dhe as nuk besojnë në jetën e amshuar...".

Myftiu falënderoi të gjitha ata që kanë kontribuar dhe ndihmuar në kthimin e identitetit të kësaj xhamie madhështore, sikurse falënderoi imamët, muezinët dhe këshillin e xhamisë që mirëmbajnë këtë ngrohtësi shpirtërore...

Në vijim ligjëruan Hfz. Ensar Ismalaj, diplomuar në Medine, Arabia Saudite si dhe H. Besim Barbullushi, diplomuar në Bursa, Turqi, të cilët përcollën mesazhe dhe këshilla të rëndësishme për xhaminë, shtëpia e Zotit, ku duhet të kuptohet si vend ku formohen personalitete të pastra dhe të sinqerta njerëzore.

Ligjëruesit e nderuar vunë theksin, se xhamia i tubon njerëzit, i bashkon dhe i edukon me frymën e vërtetë dhe të drejtë islame. Aty mund të hyjnë njerëz të të gjitha kombeve, ngjyrave dhe racave. Ajo i bashkon të gjithë popujt, pa bërë asnjë lloj diskriminimi në mes njerëzve.

Aktiviteti u transmetua live në facebook nga profili zyrtar i Myftinisë Shkodër.

MUHAMET BILALI - QYTETARI I NDERUAR DHE BESIMTARI I DENJË I QYTETIT TONË

(Me rastin e ndarjes nga jeta të mjekut veteriner, Muhamet Bilali)

Muhamet Bilali, që ishte i njohur me emrin Metush Bilali, qytetari i nderuar shkodran, njeriu i respektueshëm për të gjithë dhe nga të gjithë, besimtari i përkushtuar, u nda këto ditë nga jeta.

Edhe pse iu dhanë dekorata, lavdërime apo vlerësime të formalizuara, ai mori më shumë se ato që shkruhen e jepen në mënyrë ceremoniale nga institucionet - mori respektin dhe konsideratën e lartë të qytetarëve të Shkodrës, mori dashurinë e madhe të shokëve të tij dhe ngrohtësinë që i fali familja.

Metushi ishte i tillë i plotësuar me atë çfarë Zoti i fal një njeriu për të qenë i virtytshëm në besim i përkushtuar.

Ishte një njeri praktik që dinte ta racionalizonte kohën në mënyrë kaq optimale sa kryente çdo detyrë: atë të kryeplakut të lagjes, duke jetuar me hallet e njerëzve.

Si mjek veteriner ai dinte shumë nga mjekësia dhe mua shumë herë më jepte këshilla mjekësore të vlefshme, praktike për sëmundjet që më shqetësonin por edhe shpesh të bazuar në mjekësinë alternative.

Po kush ishte Metush Bilali?

Ai lindi në Shkodër më 1933, në familjen e shquar Bilali, familje e ardhur nga Ulqini, mbas vitit 1880. Në 1956, kryen studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, me rezultate shumë të mira ku diplomohet mjek veteriner. Ishte ndër studentët e parë të këtij fakulteti që filloi dhe mbaroi studimet në këtë fakultet. Në 1956 emërohet kryespecialist i blegtorisë në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit, Shkodër. Në 1957-58 merret me studimin e rajonizimit, seleksionimit dhe përmirësimit të racës së pastër shkodrane, leshi i të cilave ishte i preferuar për eksport e sidomos në Itali.

Në fund të vitit 1958, transferohet në zonën e lokalitetit Bushat ku punon deri më 1966. Nga ky vit deri në 1973, punon si k/specialist i blegtorisë në Oblikë-Muriqan, ku kryen edhe funksionin e n/kryetarit të kooperativës së bashkuar. Gjatë kësaj periudhe është marrë edhe me eksperimentimin e rritjes së rendimentit të bimëve të reja foragjere, si: lolium, panxhar, etj., dhe futjen e metodave të reja në silazhimin e ushqimeve për blegtori.

Nga 1974 deri në daljen në pension punoi mësues në Shkollën e Mesme Veterinare në Shkodër. Gjatë punës si arsimtar ka hartuar dy libra shkollorë: "Diagnostika veterinare" për klasat e treta të shkollës së mesme si dhe librin "Patologjia dhe terapia e kafshëve", për nxënësit maturantë.

Ka dhënë mësim në Filialin e Universitetit të Tiranës, në Shkodër, dega e Veterinarisë, në lëndët "Fiziologjia e kafshëve", "Diagnostika e sëmundjeve" dhe "Patologjia, terapia e kafshëve". Nga 1974 deri më 1989 drejtoi punën në klinikën veterinare të qytetit së bashku me mjekun veterinar A. Lika.

Është dekoruar me urdhër pune nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me urdhrin "Naim Frashëri", kl. II. i është dhënë edhe urdhri profesional i mjekut veterinar shqiptar, me motivacionin: "Për kontributin e dhënë në shërbimin veterinar, në zbatim të standardeve bashkëkohore dhe nivelin e aftë tekniko-profesional të njohurive në mbrojtje të shëndetit të kafshëve dhe të njeriut".

Metush Bilali është hartuesi i pemës gjenealogjike të fisit Bilali që daton që nga viti 1580, anëtarët e të cilit janë shpërndarë në të gjithë anët e botës.

Ishte si një arkiv i vlefshëm që kurrë nuk përtonte të tregonte për shumë ngjarje historike e sidomos për historitë detare të Ulqinit.

Ne të gjithë i lutemi Zotit që shpirti i bukur i Metushit të shkojë në xhenet duke mbetur përjetësisht i paharrueshëm.

Dr. Zenepe Dibra

Shkodër 27.03.2021

"NË GJURMËT E TË PARËVE TANË", CIKLI I LIGJËRATAVE ONLINE

Nga 12 janar 2021, nëpërmjet rrjeteve sociale, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, lajmëroi nisjen e ciklit të ri të ligjëratave me titull: "Në gjurmët e të parëve tanë", çdo të martë, të mërkurë e të enjte, në orën 20.00, drejtpërsëdrejti nga profili zyrtar i Myftiut në fb.

Nga ajo ditë e deri mbrëmjen e së enjtes, më 18 mars 2021, janë zhvilluar 30 ligjërata, nëpërmjet të cilave, Myftiu ka zbardhur gjurmë me vlerë nga trashëgimia e hoxhallarëve: H. Ismail Zoganjori, H. Sheuqet Boriçi, H. Esat Myftija, H. Jusuf Këlmendi dhe H. Ymer Bakalli.

Në këtë cikël, Myftiu i Shkodrës është angazhuar të sjellë para besimtarëve, studiuesve dhe të interesuarve gjurmë konkrete nga shkrimet, studimet, botimet dhe dorëshkrimet e hoxhallarëve tanë, prej ku del në dritë një tjetër dimension i veprës dhe kontributit të madh e të shquar të hoxhallarëve të nderuar të Shkodrës.

Nëpërmjet shpalosjes së fakteve të reja dhe shënimeve me vlerë, del në pah përkushtimi i hoxhallarëve shkodranë në disa fusha dhe lëmi të diturive islame, shfrytëzimi i mundësive të kohës për mësimin dhe edukimin e shoqërisë nëpërmjet minberit të xhumasë, shkrimit në revistat e kohës, botimet shqip me alfabet arab, dorëshkrimet në gjuhën arabe, etj.

Spikat hytbeja e H. Sheuqet Boriçit për vlerën e punës dhe ndalimin e kamatës, vargjet plot urtësi e vlerë të H. Jusuf Këlmendit, studimi i thellë dhe plot argumente i H. Ymer Bakallit, etj.

Me mbarësinë e Allahut, cikli në fjalë do të vazhdojë me gjurmë të reja që pritet të shfaqen për ne, shumë prej të cilave për herë të parë.

Mëshira e Allahut qoftë mbi të gjitha ata burra të urtë e vizionarë, që punuan për të mirën e fesë, shoqërisë, kombit e mbarë ymetit islam!

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT KUÇ

PAK HISTORI:

- Xhamia Kuç ndodhet në Njësinë Administrative Gur i Zi, zona Shkodër.

- Përbëhet prej rreth 150 familje. Fiset më të njohura janë: Toka, Lohja, Alija, Drini, Isufi, Bajraku, Fusha, Zamaku, Dreni etj.

- Pas rihapjes së besimit në vendin tonë, në fund të vitit 1990 u hap xhamia e vjetër e Kuçit, e cila brenda një kohë të shkurtër, pas një restaurimi u kthye në gjendjen e mëparshme. Në vitin 2002, sërish me kontributin e fshatit u ndërtua minarja e xhamisë. Ndërsa xhamia e re është ndërtuar në prill të viti 2013.

- Në këtë xhami nga viti i rihapjes, e deri më sot kanë shërbyer imamë

dhe mësues të mejtepeve: Hafiz Halit Mertoshi (Mandi), Haxhi Faik Zaganjori, Nuh Shem Spata, Zamir Kuke, Ilir Dizdari, Durim Kasemi, Samed Fushaj, Jetmir Maçaj, Xhevahir Alijahja, Besmir Cacani, Adil Cukali, Gazjon Rusi, Ferdinand Mema (imami aktual) dhe mësuesi aktual i kursit fetar të mësim-besimit, Ridvan Fregjaj.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 16 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2021 është rreth 260 nxënës nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vazhdën e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi, më 13 mars 2021 takimin e radhës me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Kuç.

Teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi i pasionuar, i cili me përkushtim të vazhdueshëm mirëmban këto veprimtari mjaft të rëndësishme edukative dhe arsimore.

Pas këtij takimi, nxënësit e mejtepit zhvilluan një lojë arkëtuese (minifutboll) në një prej ambienteve sportive të fshatit.

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË-MYFTINIA SHKODËR

Kalendar
Ramazan 1442
Prill/Maj 2021

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Kush e agjëron Ramazanin me besim, bindje dhe vendosmëri, atij i falen të gjitha gjynahet e kaluara."

(Buhariu dhe Muslimi)

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E XHUMA	E SHTUNË	E DIEL
PRILL - RAMAZAN	Syfyri 04:23 Dielli 06:02 Dreka 12:50 Iqindija 16:30 **Iftari 19:27** Teravia 20:54 **13**	Syfyri 04:22 Dielli 06:00 Dreka 12:50 Iqindija 16:30 **Iftari 19:28** Teravia 20:55 **14**	Syfyri 04:20 Dielli 05:59 Dreka 12:50 Iqindija 16:31 **Iftari 19:29** Teravia 20:57 **15**	Syfyri 04:18 Dielli 05:57 Dreka 12:50 Iqindija 16:31 **Iftari 19:30** Teravia 20:58 **16**	Syfyri 04:16 Dielli 05:56 Dreka 12:49 Iqindija 16:31 **Iftari 19:31** Teravia 21:00 **17**	Syfyri 04:14 Dielli 05:54 Dreka 12:49 Iqindija 16:32 **Iftari 19:32** Teravia 21:01 **18**
Syfyri 04:12 Dielli 05:53 Dreka 12:49 Iqindija 16:32 **Iftari 19:33** Teravia 21:02 **19**	Syfyri 04:10 Dielli 05:51 Dreka 12:49 Iqindija 16:32 **Iftari 19:34** Teravia 21:04 **20**	Syfyri 04:08 Dielli 05:50 Dreka 12:49 Iqindija 16:33 **Iftari 19:35** Teravia 21:05 **21**	Syfyri 04:06 Dielli 05:48 Dreka 12:48 Iqindija 16:33 **Iftari 19:36** Teravia 21:07 **22**	Syfyri 04:04 Dielli 05:47 Dreka 12:48 Iqindija 16:33 **Iftari 19:37** Teravia 21:08 **23**	Syfyri 04:02 Dielli 05:45 Dreka 12:48 Iqindija 16:34 **Iftari 19:38** Teravia 21:10 **24**	Syfyri 04:00 Dielli 05:44 Dreka 12:48 Iqindija 16:34 **Iftari 19:39** Teravia 21:11 **25**
Syfyri 03:58 Dielli 05:42 Dreka 12:48 Iqindija 16:34 **Iftari 19:41** Teravia 21:13 **26**	Syfyri 03:57 Dielli 05:41 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:42** Teravia 21:14 **27**	Syfyri 03:55 Dielli 05:40 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:43** Teravia 21:16 **28**	Syfyri 03:53 Dielli 05:38 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:44** Teravia 21:17 **29**	Syfyri 03:51 Dielli 05:37 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:45** Teravia 21:19 **30**	Syfyri 03:49 Dielli 05:36 Dreka 12:47 Iqindija 16:36 **Iftari 19:46** Teravia 21:20 **1**	Syfyri 03:47 Dielli 05:34 Dreka 12:47 Iqindija 16:36 **Iftari 19:47** Teravia 21:22 **2**
MAJ - RAMAZAN Syfyri 03:45 Dielli 05:33 Dreka 12:47 Iqindija 16:36 **Iftari 19:48** Teravia 21:24 **3**	Syfyri 03:44 Dielli 05:32 Dreka 12:47 Iqindija 16:37 **Iftari 19:49** Teravia 21:25 **4**	Syfyri 03:42 Dielli 05:31 Dreka 12:46 Iqindija 16:37 **Iftari 19:50** Teravia 21:27 **5**	Syfyri 03:40 Dielli 05:29 Dreka 12:46 Iqindija 16:37 **Iftari 19:51** Teravia 21:28 **6**	Syfyri 03:38 Dielli 05:28 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:52** Teravia 21:30 **7**	Syfyri 03:37 Dielli 05:27 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:53** Teravia 21:31 **8**	Syfyri 03:35 Dielli 05:26 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:54** Teravia 21:33 **9**
Syfyri 03:33 Dielli 05:25 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:55** Teravia 21:34 **10**	Syfyri 03:32 Dielli 05:24 Dreka 12:46 Iqindija 16:39 **Iftari 19:56** Teravia 21:36 **11**	Syfyri 03:30 Dielli 05:23 Dreka 12:46 Iqindija 16:39 **Iftari 19:57** Teravia 21:37 **12**	**13 FITËR BAJRAMI** **1 Shevval 1442**			

- **NATA E KADRIT,** e shtunë, më **8 maj 2021**
- **FITËR BAJRAMI**, e enjte, më **13 maj 2021**
  (Bajrami falet në orën 06:10)

Falja e Sabahut në xhami bëhet 30 minuta pas Imsakut *(Syfyrit)*
Oraret janë referuar zonës së Shkodrës

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek